REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 788 Prot. Tiranë, më 11.05.2022

# UDHËZIM

**Nr. 47, datë 11.05.2022**

**PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIT NR. 1, DATË 06.12.2021 "PËR HARTIMIN, BASHKËRENDIMIN, MIRATIMIN DHE KONTROLLIN E PROCESIT TË RISHIKIMIT TË DOKUMENTEVE TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE ME PROCEDURË TË THJESHTUAR"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit*", VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "*Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit*", e ndryshuar;

**UDHËZOJ:**

1. Pika 4 e Udhëzimit nr. 01, datë 06.12.2021 ndryshohet si më poshtë:
   "4. Pjesë integrale e këtij Udhëzimi është:
      a. **Shtojca I**, ku përcaktohet në mënyrë të detajuar procedura për rishikimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, referuar pikës 3 të këtij Udhëzimi.
      b. **Shtojca II**, ku përcaktohet formati tip i Raportit Përmbledhës të Kërkesave për Ndryshime të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore.

2. Përdorimin e formatit tip të Raportit Përmbledhës të Kërkesave për Ndryshime të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, sipas Shtojcës II bashkëlidhur.

3. Ngarkohen Autoritetet Vendore, të cilat ndërmarrin nismën për rishikimin e dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Udhëzimi.

4. Ngarkohen Autoritetet Vendore të bashkërendojnë punën me AKPT, gjatë procesit të rishikimit të dokumenteve të Planeve të Përgjithshme Vendore.

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Adelina GRECA**

**SHTOJCA II**

# Bashkia X
# Rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor

# Raport Përmbledhës[1]
# i Kërkesave për Ndryshime[2]

## Draft x
## Datë xx.xx.xxxx

**Hartoi**
*Eksperti i Planifikimit: emër mbiemër, sigla*
*Eksperti Juristi: emër mbiemër, sigla*
*Eksperti GIS: emër mbiemër, sigla*
*Eksperti i Mjedisit: emër mbiemër, (nr. Licence), sigla*

---

[1] Për hartimin e këtij raporti nevojitet një **ekip i angazhuar** i përbërë nga minimalisht: 1. **Ekspert planifikues, 2. Ekspert jurist, 3. Ekspert GIS, 4. Ekspert mjedisi** (preferohet i licencuar)

[2] Formati i Raportit Përmbledhës është krijuar **për të unifikuar kërkesat e Bashkive** të ndryshme, për të **lehtësuar komunikimin ndërinstitucional** mes Bashkive, AKPT-së dhe institucioneve të tjera me të cilët do të bashkërendohet përpara miratimit të kërkesave për ndryshime.
**Formati i Raportit mund të pësojë ndryshime të vazhdueshme nga AKPT**, në përpjekjen e pandalur për të përmirësuar dhe lehtësuar punën e instituacioneve pjesëmarrëse në proces.
**Struktura e Raportit** ndjek **Strukturën e Dokumentit të Ndryshimeve të PPV-së**, sipas standardit të krijuar tashmë.
Nëse Raporti Përmbledhës, **nuk do të dorëzohet nga Bashkitë i plotësuar sipas formatit tip dhe i plotë**, AKPT dhe institucionet bashkërenduese **nuk do të vijojnë shqyrtimin** e përmbajtjes së tij dhe **do të kërkojnë menjëherë plotësimin** e raportit.

**Tabela e Përmbajtjes**


KREU I
*NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË*

KREU II
*NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT (PASAPORTAT)*

KREU III
*NDRYSHIME NË HARTËN E RRJETIT RRUGOR E INFRASTRUKTUROR*

SHTOJCA I
*TABELA PËRMBLEDHËSE E NJËSIVE STRUKTURORE KU KËRKOHEN NDRYSHIME DHE E NJËSIVE TË REJA QË PROPOZOHEN TË SHTOHEN*

SHTOJCA II
*RAPORTI I EKSPERTIT TË MJEDISIT MBI SECILIN PREJ RASTEVE TË PROPOZUARA PËR RISHIKIM, KU DETAJOHET:*

1. *NËSE SECILI PREJ RASTEVE CËNON OSE JO VLERAT NATYRORE, MJEDISORE DHE ZONAT E MBROJTURA,*
2. *NËSE SECILI PREJ RASTEVE DUHET T'I NËNSHTROHET OSE JO HARTIMIT TË VSM-SË*

**KREU I**
**NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PPV-SË**

**Paraqitja e kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
*Neni si është dhe si propozohet (kur kërkohet ndryshim i përmbajtjes së nenit)*
*Neni i ri (në rastet kur kërkohet shtim i një neni të ri në Rregullore)*
*Shtesa në nenin x (kur kërkohen shtesa të pikave, apo fjalive në nenin ekzistues)*

**Argumentimi i Kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të shpjegojë arsyet/nevojat që sjellin kërkesën për ndryshim (duke referuar rastet e pikës 2 të Nenit 26 të Ligjit Nr.107/2014).*

*A. Arsyet pse kërkohet Ndryshimi*
*A.1 Ndarja Administrative Territoriale* ☐
*A.2 Ndryshime Demografike* ☐
*A.3 Ndryshime Sociale* ☐
*A.4 Ndryshime Ekonomike* ☐
*A.5 Kriza Sektoriale* ☐
*A.6 Forca Madhore* ☐
*A.7 Harmonizimi me Dokumente e Projekte Madhore* ☐
*A.8 Ndryshime Ligjore* ☐
*A.9 Përafrime Ligjore me BE-në* ☐
*A.10. Korrigjim, Lapsuse, Mospërputhje mes pjesëve të Dokumentit të PPV* ☐

*Gjithashtu, bashkia duhet të shpjegojë se çfarë synohet të arrihet nëpërmjet ndryshimit të propozuar në nenin e Rregullores.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar në Rregulloren e Planit është në përputhje me legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në fuqi.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar në Rregulloren e Planit është në përputhje me legjislacionet e tjera sektoriale në fuqi, sipas rastit.*

**Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve (e plotë/ e thjeshtuar)** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të vleresojë nëse ndryshimi i kërkuar përfshihet në ndryshimet që trajtohen me procedurë të plotë apo procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM Nr.686/2017, e ndryshuar), sipas listës m poshtë:*

*B. Kriteret për PROCEDURËN E THJESHTUAR*
*B.1 Rishikim i Pjesshëm (për një pjesë të territorit administrativ)* ☐
*B.2 NUK CËNON Vlerat Natyrore e Mjedisore* ☐
*B.3 NUK CËNON Zonat e Mbrojtura* ☐
*B.4 NUK CËNON Trashëgiminë Historike e Kulturore* ☐
*B.5 NUK NDRYSHON Strategjinë Territoriale* ☐

## KREU II
## NDRYSHIME NË TABELËN E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT (PASAPORTAT)

**Paraqitja e kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
*Kodi i Njësisë* ***Strukturore*** *ku kërkohet ndryshimi.*
***Treguesit e Zhvillimit*** *që kërkohen të ndryshohen:* ***si janë*** *dhe* ***si propozohen*** *pas ndryshimit, sipas modelit më poshtë.*
***Kodi i Njësisë së Re Strukturore****, e shoqëruar me Treguesit e Zhvillimit të propozuar.*
***Kodi i Njësive Strukturore kufitare****, nëse kërkesa shoqërohet me ndryshime të kufijve të njësive strukturore kufitare.*
*Nëse kërkesa për ndryshim sjell* ***ndryshime të konfigurimit*** *të njësisë strukturore dhe atyre fqinje, atëhere ajo* ***duhet të ilustrohen me imazhe****, ku të jetë e qartë se si janë kufijtë dhe si propozohet të ndryshojnë.*






**Argumentimi i Kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të shpjegojë arsyet/nevojat që sjellin kërkesen për ndryshim (duke referuar rastet e pikës 2 te Nenit 26 të Ligjit Nr.107/2014).*

*A. Arsyet pse kërkohet Ndryshimi*
*A.1 Ndarja Administrative Territoriale*
*A.2 Ndryshime Demografike*
*A.3 Ndryshime Sociale*
*A.4 Ndryshime Ekonomike*
*A.5 Kriza Sektoriale*
*A.6 Forca Madhore*
*A.7 Harmonizimi me Dokumente e Projekte Madhore*
*A.8 Ndryshime Ligjore*
*A.9 Përafrime Ligjore me BE-në*
*A.10. Korrigjim, Lapsuse, Mospërputhje mes pjesëve të Dokumentit të PPV*

*Bashkia duhet të shpjegojë arsyet/nevojat që sjellin kërkesën për ndryshim dhe çfarë synohet të arrihet nëpërmjet ndryshimit të propozuar në Pasaportën e Njësisë Strukturore.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar në Tabelën e Treguesve të Zhvillimit të Planit është në përputhje me legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në fuqi.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar në Tabelën e Treguesve të Zhvillimit është në përputhje me legjislacionet e tjera sektoriale në fuqi, sipas rastit.*

**Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve (e plotë/ e thjeshtuar)** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të vlerësojë nëse ndryshimi i kërkuar përfshihet në ndryshimet që trajtohen me procedurë të plotë apo procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM Nr.686/2017, e ndryshuar), duke u bazuar në listën më poshtë. Në rast se nuk plotësohet një nga pikat e listës më poshtë, ndryshimi vlerësohet për procedurë të plotë.*

***B. Kriteret për PROCEDURËN E THJESHTUAR***

*B.1 Rishikim i Pjesshëm (për një pjesë të territorit administrativ)* ☐
*B.2 NUK CËNON Vlerat Natyrore e Mjedisore* ☐
*B.3 NUK CËNON Zonat e Mbrojtura* ☐
*B.4 NUK CËNON Trashëgiminë Historike e Kulturore* ☐
*B.5 NUK NDRYSHON Strategjinë Territoriale* ☐

**KREU III**
**NDRYSHIME NË HARTËN E RRJETIT RRUGOR E INFRASTRUKTUROR**

**Paraqitja e kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
***Emërtimi i aksit/ infrastrukturës*** *për të cilën kërkohet ndryshimi.*
***Treguesit e Infrastrukturës*** *që kërkohen të ndryshohen:* ***si janë*** *dhe* ***si propozohen*** *pas ndryshimit (koordinatat/ gjurma, kategoria, profili, etj).*
***Shtimi i një infrastukture të re****, e shoqëruar me treguesit përkatës.*
***Kodi i Njësive Strukturore kufitare****, nëse kërkesa shoqërohet me ndryshime të kufijve të njësive strukturore kufitare.*
*Nëse kërkesa për ndryshim sjell* ***ndryshime të konfigurimit*** *të njësisë së infrastrukturës dhe atyre fqinje, atëherë ajo* ***duhet të ilustrohen me imazhe****, ku te jete e qarte se si janë kufijtë dhe si propozohet të ndryshojnë.*

| *Imazh ilustrues i ndryshimit të kërkuar* |
|---|

**Argumentimi i Kërkesës** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të shpjegojë arsyet/nevojat që sjellin kërkesën për ndryshim (duke referuar rastet e pikës 2 të Nenit 26 të Ligjit Nr.107/2014).*

***A. Arsyet pse kërkohet Ndryshimi***
*A.1 Ndarja Administrative Territoriale* ☐
*A.2 Ndryshime Demografike* ☐
*A.3 Ndryshime Sociale* ☐
*A.4 Ndryshime Ekonomike* ☐
*A.5 Kriza Sektoriale* ☐
*A.6 Forca Madhore* ☐
*A.7 Harmonizimi me Dokumente e Projekte Madhore* ☐
*A.8 Ndryshime Ligjore* ☐
*A.9 Përafrime Ligjore me BE-në* ☐
*A.10. Korrigjim, Lapsuse, Mospërputhje mes pjesëve të Dokumentit të PPV* ☐

*Bashkia duhet të shpjegoje arsyet/nevojat që sjellin kërkesën për ndryshim dhe çfarë synohet të arrihet nëpërmjet ndryshimit të propozuar të Infrastrukturës.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me Ligjin Nr.107/2014, VKM Nr.686/2017 dhe VKM Nr.408/2015** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar për Infrastrukturën e Planit është në përputhje me legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në fuqi.*

**Përputhshmëria e Kërkesës me legjislacionet sektoriale në fuqi** (plotësohet për secilin rast):
*Bashkia duhet të argumentojë që ndryshimi i kërkuar në Infrastrukturë është në përputhje me legjislacionet e tjera sektoriale në fuqi, sipas rastit.*

**Vlerësimi për llojin e procedurës për miratimin e ndryshimeve (e plotë/ e thjeshtuar)** (plotësohet për secilin rast):

*Bashkia duhet të vlerësojë nëse ndryshimi i kërkuar përfshihet në ndryshimet që trajtohen me procedurë të plotë apo procedurë të thjeshtuar, sipas përcaktimeve të pikave 3 dhe 4 të Nenit 11, të VKM Nr.686/2017, e ndryshuar), duke u bazuar në listën më poshtë. Në rast se nuk plotësohet një nga pikat e listës më poshtë, ndryshimi vlerësohet për procedure të plotë.*

***B. Kriteret për PROCEDURËN E THJESHTUAR***

*B.1 Rishikim i Pjesshëm (për një pjesë të territorit administrativ)* ☐
*B.2 NUK CËNON Vlerat Natyrore e Mjedisore* ☐
*B.3 NUK CËNON Zonat e Mbrojtura* ☐
*B.4 NUK CËNON Trashëgiminë Historike e Kulturore* ☐
*B.5 NUK NDRYSHON Strategjinë Territoriale* ☐

**SHTOJCA I**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E NJËSIVE STRUKTURORE KU KËRKOHEN NDRYSHIME DHE E NJËSIVE TË REJA QË PROPOZOHEN TË SHTOHEN**

**Tabela përmbledhëse**

| *Nr.* | *Kodi i Njësisë Strukturore* | *Lloji i ndryshimit të kërkuar* | *Lloji i procedurës (e plotë/ e thjeshtuar)* |
|---|---|---|---|
| *1* | *Kodi* | *Ndryshim i kufijve të njësise (zgjerim/ zvogëlim)* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *2* | *Kodi* | *Ndryshon kufijtë si rrjedhojë e ndryshimeve të njësisë kufitare* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *3* | *Kodi* | *Ndahet në dy ose më shumë njësi strukturore* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *4* | *Kodi* | *Njësi e re* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *5* | *Kodi* | *Ndryshim të Treguesve të Zhvillimit* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *6* | *Kodi* | *Ndryshim i kufijve të njësisë dhe Treguesve të Zhvillimit* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |
| *7* | *Kodi* | *Etj. kombinime sipas rastit* | *Sipas vlerësimit (e plotë/ e thjeshtuar)* |

**SHTOJCA II**
**RAPORTI I EKSPERTIT TË MJEDISIT MBI SECILIN PREJ RASTEVE TË PROPOZUARA PËR RISHIKIM, KU DETAJOHET:**

1. **NËSE SECILI PREJ RASTEVE CËNON OSE JO VLERAT NATYRORE, MJEDISORE DHE ZONAT E MBROJTURA,**
2. **NËSE SECILI PREJ RASTEVE DUHET T'I NËNSHTROHET OSE JO HARTIMIT TË VSM-SË**

**Struktura e Raportit**
*Raporti duhet të vlerësojë* ***secilin rast****, ose* ***grup-rastet e ngjashme****, me fokus dy pikat: 1.* ***Cënon ose jo vlerat*** *natyrore, mjedisore dhe* ***zonat*** *e mbrojtura; 2. Duhet t'i* ***nënshtrohet ose jo hartimit të VSM-së****.*

*Raporti duhet të jetë* ***i argumentuar*** *dhe me* ***referenca ligjore****, në mënyrë që të jetë i bazuar dhe i pranuar nga autoritetet me të cilat do të bashkërendohet Dokumenti i Rishikimit të PPV-së.*

*Raporti duhet të siglohet nga Eksperti i Mjedisit (preferohet i licencuar).*